



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 21 shtator 2015  
Nr. ref.: RK 845/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KO107/15**

Parashtrues

**Albulena Haxhiu dhe 23 deputetë të tjerë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

## **Parashtruesit e kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë: Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Puhie Demaku, Albin Kurti, Salih Salihu, Besa Baftiu, Besnik Bislimi, Faton Topalli, Shqipe Pantina, Ismajl Kurteshi, Fisnik Ismaili, Donika Kadaj-Bujupi, Time Kadrijaj, Teuta Haxhiu, Rustem Berisha, Lahi Ibrahimaj, Daut Haradinaj, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Valdete Bajrami, Shukrije Bytyqi, Haxhi Shala, Enver Hoti dhe Zafir Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi). Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar znj. Albulena Haxhiu për t'i përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139 e Kuvendit për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar si në baza përmbajtjesore, ashtu edhe në baza procedurale.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar miraton Amendamentin XXIV të Kushtetutës, që është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese: me nenin 1, paragrafët (1) dhe (2) [Përkufizimi i Shtetit]; me nenin 3 [Barazia para Ligjit]; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; me nenin 35 [Liria e Lëvizjes]; me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; me nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]; me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]; me nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] dhe me nenet 132, 134 dhe 135 [përkitazi me Avokatin e Popullit].
5. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur, që çoi deri te votimi dhe deri te miratimi i vendimit të kontestuar, nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 113.9 dhe me nenin 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta].

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës dhe në nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## Procedura në Gjykatë

7. Më 11 gusht 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 12 gusht 2015, znj. Albulena Haxhiu dorëzoi kopjet e letërnjoftimeve të të gjithë parashtruesve të kërkesës.
9. Më 12 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO107/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO107/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
10. Më 13 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesja e parashtruesve që të dorëzonin në Gjykatë një kopje të vendimit të kontestuar, duke përfshirë shtojcat e tij, me qëllim të kompletimit të kërkesës.
11. Më 14 gusht 2015, përfaqësuesja e parashtruesve të kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara, që përmbanin Vendimin nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV dhe tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV.
12. Më 14 gusht 2015, Gjykata e njoftoi Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) dhe Kryetarin e Kuvendit për parashtrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta që të dorëzonin komentet e tyre lidhur me kërkesën. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga Qeveria dhe nga Kryetari i Kuvendit që t'i siguronin Gjykatës dosjen e plotë lidhur me projektamendamentin si dhe çdo dokument mbështetës që i ishte dërguar Kuvendit, respektivisht deputetëve të Kuvendit.
13. Të njëjtën ditë u informua Presidentja e Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Presidentja e Republikës] për kërkesën e dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesit.
14. Më 17 gusht 2015, Kryetari i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dosjet e kërkuara që përmbanin dokumentet e mëposhtme:
  - a. dosjen që i ishte dorëzuar deputetëve të Kuvendit më 31 korrik 2015 për përgatitjen e seancës plenare të 3 gushtit 2015, që përfshinte Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV në Kuvend, tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 14 prillit 2015, në Rastin KO26/15;
  - b. transkriptin e seancës plenare të Kuvendit të 3 gushtit 2015;
  - c. procesverbalin e seancës së Kuvendit të 3 gushtit 2015;
  - ç. Vendimin nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV;
  - d. tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV; dhe
  - dh. evidencën e votimit elektronik të 3 gushtit 2015 për miratimin e Amendamentit XXIV.
15. Më 18 gusht 2015, Qeveria i dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara. Këto dokumente përfshinin: shkresën e Kryeministrit, me të cilën Amendamenti

XXIV u riprocedua për votim, Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV dhe tekstin e amendamentit të propozuar.

16. Më 19 gusht 2015, Presidentja e Republikës i dërgoi letër Kryetares së Gjykatës, në të cilën kërkonte sqarime përkitazi me implikimet e kësaj kërkesë në obligimet e Presidentes nga neni 80 i Kushtetutës. Kjo kërkesë, në mënyrë specifike, kishte të bënte me nënshkrimin dhe me shpalljen e dy ligjeve që ishin miratuar nga Kuvendi në bazë të Amendamentit XXIV të Kushtetutës.
17. Më 20 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës u përgjigj në letrën e Presidentes së Republikës, duke sqaruar se kërkesa KO107/15 kishte të bënte me kontestimin e Vendimit të Kuvendit, nr. 05-V-139, për miratimin e Amendamentit XXIV të 3 gushtit 2015. Kryetarja e Gjykatës, po ashtu, e informoi Presidenten e Republikës se kushtetutshmëria e dy ligjeve të lartpërmendura nuk ishte duke u kontestuar në Gjykatën Kushtetuese.
18. Më 28 gusht 2015, Kryeministri i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri) e dorëzoi një letër në Gjykatë që përmbante komentet e Qeverisë.
19. Më 8 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

20. Më 7 mars 2015, Qeveria vendosi t'i propozonte Kuvendit të Republikës së Kosovës një amendament të Kushtetutës.
21. Të njëjtën ditë, Qeveria, në bazë të nenit 144.1 të Kushtetutës, i propozoi Kryetarit të Kuvendit tekstin e amendamentit të Kushtetutës.
22. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit e referoi në Gjykatë tekstin e amendamentit të propozuar të Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata që ajo të bënte vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar zvogëlonte ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata e regjistroi kërkesën me numër KO26/15.
23. Më 14 prill 2015, Gjykata mbajti këshillime për kërkesën dhe nxori Aktgjykimin AGJ788/15, me të cilin konfirmoi se Amendamenti i propozuar XXIV nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe, me shkronjën dhe frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.
24. Më 26 qershor 2015, Kuvendi shqyrtoi dhe votoi për Amendamentin e propozuar XXIV dhe, me 75 vota për, me 7 vota kundër dhe me 2 abstenime, dështoi ta miratonte atë.
25. Më 31 korrik 2015, Qeveria vendosi të riprocedonte Amendamentin e propozuar XXIV në Kuvend për një votim tjetër.
26. Të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit i njoftoi të gjithë deputetët e Kuvendit për riprocedimin e amendamentit të propozuar. Në këtë njoftim përfshihej një

kopje e Vendimit të Qeverisë, teksti i Amendamentit të propozuar XXIV dhe një kopje e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KO26/15.

27. Të njëjtën datë, Kryetari i Kuvendit thirri mbledhje të Kryesisë së Kuvendit, gjatë së cilës u vendos që amendamenti i propozuar të vihej në votim më 3 gusht 2015.
28. Më 3 gusht 2015, Kuvendi shqyrtoi dhe votoi për amendamentin e propozuar dhe, me Vendimin nr. 05-V-139, me 82 vota për, me 5 vota kundër dhe me 1 abstenim, e miratoi atë.
29. Më 5 gusht 2015, Amendamenti XXIV u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare].

### **Argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës**

30. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139, si në baza përmbajtjesore ashtu edhe në baza procedurale.

### ***Sa i përket aspektit përmbajtjesor të kërkesës***

31. Pavarësisht faktit se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139, Gjykata vëren se argumentet e paraqitura nga ta nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e atij vendimi, por ato kanë të bëjnë me përmbajtjen e tekstit të Amendamentit XXIV dhe mund të përmbliidhen si në vijim:
32. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se *“me këtë dispozitë përmbysen i gjithë sistemi kushtetues duke pasur parasysh se dispozitat e këtij amendamenti janë në kundërshtim të plotë me karakterin dhe subjektivitetin e Republikës së Kosovës. Kështu që nisur nga dispozitat e përgjithshme të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht Nenit 1, par. 1 dhe 2 dhe Neni 3 lidhur me Nenin 24, Neni 102, 103 dhe 104 mbi organizimin e sistemit gjyqësor, përmbajtja e këtij neni e zhvesh shtetin e Kosovës edhe në aspekt formal sa i përket shtetësisë dhe karakterit republikan”*.
33. Më tej, parashtruesit e kërkesës paraqesin argumentet e tyre përkitazi me secilin paragraf të amendamentit. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se pavarësisht faktit që paragrafi 1 i këtij amendamenti thotë se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohen në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës *“... sipas përmbajtjes së amendamentit, askund nuk specifikohen elementet e varësisë së këtij organizmi në raport me organet kushtetuese të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, emërimi, përzgjedhja dhe përgjegjësia e bartësve të këtij organizmi nuk është sanksionuar, madje i janë njohur kompetencat e veçanta në aspektin lëndor dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale të shqiptuara nga trupat gjykues të këtij organizimi paralel”*.
34. Sipas parashtruesve të kërkesës, paragrafi 2 i Amendamentit XXIV, parashikon garancitë procedurale për personat e akuzuar potencialë në pajtim me nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës, por ai është në kundërshtim me dispozita të tjera të këtij amendamenti. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *“proklamimi i të drejtave*

*elementare duke u thirrur në Kapitullin II dhe në veçanti Nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës dhe në anën tjetër dispozitat e këtyre paragrafëve të jenë të përjashtuara nga krahassimi si dhe kolizioni me dispozitat e tjera të Kushtetutës është argumenti juridik se këto dispozita kanë edhe kolizion përmbajtësor ndërmjet tyre dhe me pjesën tjetër të dispozitave kushtetuese”.*

35. Parashtruesit e kërkesës po ashtu argumentojnë se paragrafi 3 i Amendamentit XXIV është jokushtetues. Konkretisht, kjo dispozitë përcakton që një Dhomë e Specializuar, e përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë, do të themelohet në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, e cila do të vendosë ekskluzivisht për kërkesat kushtetuese që kanë të bëjnë me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Sipas parashtruesve të kërkesës, “... *Dhoma e specializuar siç është quajtur nga sponsorizuesi është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 114 të Kushtetutës për sa i përket përbërjes së saj. Elementi tjetër sa i përket kolizionit që janë duke krijuar këto norma në këtë amendament është edhe kompetenca lëndore kësaj dhome të ‘specializuar’ në raport me Nenin 112 dhe 113 të Kushtetutës”.*
36. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 4 i Amendamentit XXIV, duke i dhënë Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar aftësi të plotë juridike, subjektivitet juridik dhe të gjitha autorizimet e mandatin e nevojshëm për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare me shtete të treta, “... *ia jep këtij institucioni atributin e sovranitetit të jashtëm që është komponent thelbësor i kuptimit të plotë të nocionit të sovraniteti shtetëror. Për këtë kjo dispozitë përjashton madje edhe bartësin kryesor të kontrollit të sovranitetit të jashtëm e ai është Kuvendi”.*
37. Ngjashëm, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafi 5 i Amendamentit XXIV “*i cenon kompetencat e Kuvendit të Kosovës siç janë paraparë me Nenin 65, pikës 4 të Kushtetutës përkitazi me kompetencën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra pëlqimi për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare që do t’i lidhin Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të merret vetëm nga Qeveria dhe jo nga Kuvendi i Kosovës siç është paraparë me Nenin 18 të Kushtetutës”.*
38. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se kompetenca dhënë Dhomave të Specializuara, në paragrafin 6 të Amendamentit XXIV, për të përcaktuar rregulloren e tyre të punës, “... *hap mundësinë që procedimi i çështjeve pranë këtij mekanizmi gjyqësor të jetë përjashtues për qytetarët e Republikës së Kosovës në kuptim të zbatimit të së drejtës pozitive. Kjo korrespondon drejtpërdrejt në kundërshtim me Nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës edhe me përmbajtjen e të drejtave të sanksionuara me aktet ndërkombëtare që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë sipas Nenit 22 të Kushtetutës”.*
39. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafët 7 dhe 8 të Amendamentit XXIV, që rregullojnë çështjen e selive të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe lokacionin gjeografik ku do të vendosen personat e akuzuar dhe personat e dënuar, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas parashtruesve të kërkesës “... *kufizimi i ndërvarësisë në mes të shtetasit dhe shtetit të Kosovës e bën të diskriminuar qytetarin e Kosovës ndaj të cilit mbahet gjykimi, i shqiptohet dënimi dhe*

*ekzekutohet në procedura të veçanta dhe në territor tjetër. Kjo çështje ndërlidhet me ekstradimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës e që sipas Nenit 35, paragrafit 4, ekstradimi i qytetarëve të Kosovës në kuadër të së drejtës themelore të njeriut përkitazi me lirinë e lëvizjes, ndalohet ekstradimi i tij, përjashtimisht kur kjo është e rregulluar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare”.*

40. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu konsiderojnë se paragrafi 10 i Amendamentit XXIV, që parashikon se do të miratohet ligj i veçantë për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, me mbikëqyrjen dhe me administrimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, është në kundërshtim me nenin 102 të Kushtetutës, pavarësisht faktit se “... në paragrafin 1 të këtij amendamenti atyre u referohen si nën sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës”.
41. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 11 i Amendamentit XXIV, që parashikon se do të themelohet një Ombudsperson i veçantë me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse ai/ajo “... nuk do të zgjidhet dhe as nuk do t’i raportojë Kuvendit të Kosovës sipas dispozitave të Neneve 132, par. 2 dhe Neneve 134 dhe 135 par. 1 dhe 2 të Kushtetutës së Kosovës”.
42. Më tej, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se paragrafi 12 i Amendamentit XXIV, që rregullon me marrëveshje ndërkombëtare çështjet e mbikëqyrjes, të financimit, të buxhetit, të auditimit dhe aspekte të tjera të organizimit dhe të funksionimit të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, krijon standard të dyfishtë dhe do të “... formalizojë kundërshtimin e brendshëm kushtetues lidhur me Nenin 3 dhe Nenin 102 të Kushtetutës, dhe në aspektin e të drejtave të njeriut nga Kapitulli II, do të vijë deri tek cenimi i Nenit 24, dhe Nenit 22 përkitazi me Nenin 7 të DUDNJ-së përkitazi me të drejtën në trajtim dhe mbrojtje të barabartë para ligjit”.
43. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pohojnë se paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit XXIV, përkitazi me mandatin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, “... krijojnë pasiguri juridike dhe kushtetuese dhe një normim i tillë e cenon rendin juridik në përgjithësi sepse përderisa dispozitat kushtetuese kalojnë nëpër një procedure të veçantë kushtetuese dhe miratimin sipas shumicës së dyfishtë të kualifikuar në pajtim me Nenin 144, par. 2 të Kushtetutës, akti në të cilin janë referuar këto dy paragrafë miratohen me shumicë të njëfishtë, të kualifikuar dhe i njëjti i nënshtrohet rregullimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

44. Në fund,

*“Parashtruesit e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Amendamentit kushtetues nr. XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderojnë se dispozitat e këtij amendamenti në aspektin përmbajtësor janë në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, respektivisht me dispozitat konkrete kushtetuese:*

*Neni 1, paragrafët (1) dhe (2) - Përkufizimi i Shtetit*

*Neni 3 - Barazia para Ligjit*

*Neni 22 - Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare - lidhur me Nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut*

*Neni 24 - Barazia para Ligjit*

*Neni 35 - Liria e Lëvizjes*

*Neni 45 - Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes*

*Neni 102 - Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor*

*Neni 103 - Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave*

*Neni 104 - Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve*

*Neni 114 - Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*

*Nenet 132, 134 dhe 135 - përkitazi me Avokatin e Popullit”.*

### ***Sa i përket aspektit procedural të kërkesës***

45. Në lidhje me procedurën e ndjekur për miratimin e vendimit të kontestuar, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se kanë ndodhur edhe shkelje procedurale.
46. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pohojnë se pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Kryesisë së Kuvendit, të 31 korrikut 2015, ku ishte vendosur që seanca plenare për rivotimin e Amendamentit XXIV të mbahej më 3 gusht 2015, “... nuk i është dërguar materiali përcjellës i cili do të shqyrtohej në seancën plenare”.
47. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës citojnë nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës që përcaktojnë se, para vënies në votim të një amendamenti të Kushtetutës në Kuvend, amendamenti i propozuar duhet të referohet nga Kryetari i Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese për të konfirmuar se amendamenti i propozuar nuk zvogëlon të drejtat e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës theksojnë:

*“Përkundër vendimit të Kuvendit të Kosovës, marrë në seancën plenare të datës 26 qershor 2015, Qeveria e Kosovës më datën 31 korrik 2015 e ka riproceduar në Kuvendin e Kosovës propozim-amendamentin me përmbajtje të njëjtë duke mos e marrë parasysh vendimin e marrë nga Kuvendi i Kosovës më datën 26 qershor 2015. [...] Kryetari i Kuvendit duhej që para procedimit të propozimamendamentit të Qeverisë së Kosovës ta dërgonte të njëjtin pranë Gjykatës Kushtetuese për vlerësim”.*



48. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se referimi i amendamentit të propozuar në Gjykatën Kushtetuese është obligues dhe formulimi i nenit 113.9 i Kushtetutës nuk lejon asnjë variacion. *“Në kuptim të kësaj dispozite, këtu nuk merret fare parasysh e drejta diskrecionale e Kryetarit të Kuvendit që të alternojë procedimin e një propozim-ndryshimi kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese”.*
49. Sipas parashtruesve të kërkesës *“... Gjykata Kushtetuese është i vetmi organ shtetëror i cili ka autorizimin kushtetues që të bëjë konstatimin lidhur me cilindo propozim për ndryshimin e Kushtetutës në raport me të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.*

[...]

*Prezumimet procedurale kanë karakter qenësor për të garantuar përmbajtjen e drejtë të lëndës për të cilën zhvillohet procedura përkatëse referuar maksimës "forma data esse rei " (forma e përcakton përmbajtjen). Për këtë cenimi i prezumimeve procedurale që kanë karakter absolut, e që në rastin konkret natyra imperative e dispozitës së Nenit 113.9 është e pakontestueshme, e bën që materia e proceduar sipas deformimit procedural e konteston legjitimitetin e vetë përmbajtjes së materies, së cilës i jepet fuqia juridike pikërisht në këtë procedurë”.*

50. Ngjashëm, parashtruesit e kërkesës argumentojnë se neni 144.3 *“... jep kuptimin e kushtit për cilindo procedim që ndërlidhet me ndryshimet kushtetuese. Pra, një amendament nuk ka mundësi të hynë në fuqi edhe pse i ka përmbushur kushtet për miratim nga shumica e kualifikuar sipas Nenit 144.2 të Kushtetutës së Kosovës”.*
51. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë rëndësinë e nenit 144.3, duke thënë: *“Nëse çështjen në fjalë e sqarojmë përmes rregullave të interpretimit sistematik, mjafton që ta kemi parasysh paragrafin 4 të Nenit 144 i cili e përcakton momentin e hyrjes në fuqi të një amendamenti kushtetues të votuar nga Kuvendi i Kosovës. Pra, renditja e paragrafit 4 pas paragrafit 3 është tregues se procesi i miratimit të një amendamenti kushtetues dhe hyrja në fuqi e tij është e kushtëzuar nga paragrafi 3 i Nenit 144 të Kushtetutës”.*
52. Parashtruesit e kërkesës përmyllin argumentet lidhur me aspektin procedural të shkeljeve të pretenduara, duke përfshirë edhe rregullin 82 të Rregullores së punës të Kuvendit, që reflekton dispozitat kushtetuese përkitazi me procedurat e miratimit të amendamenteve të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se këto procedura nuk janë respektuar.

### **Komentet e dorëzuara nga Kryeministri**

53. Në letrën e Kryeministrit, të 28 gushtit 2015, thuhet: *“... Amendamenti XXIV i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i dorëzuar nga Qeveria në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datën 31 Korrik 2015 dhe i miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të datës 03 Gusht 2015, është IDENTIK me tekstin që ishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese dhe vlerësuar nga kjo Gjykatë në rastin K026-15, respektivisht me Aktgjykimin AGJ 788/15”.*

54. Për më tepër, në letër argumentohet se “të gjitha këto pretendime janë të pabazuara për arsye se lidhur me këtë çështje tashmë kemi një Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin ishte konstatuar se Amendamenti XXIV nuk zvogëlon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas Kapitullit II dhe III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
55. Në fund, i propozohet Gjykatës: “... ta **DEKLARONI SI TË PAPRANUSHME** [kërkesën KO107/15], duke qenë se kemi të bëjmë me një çështje tashmë të gjykuar (res judicata)”.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

56. Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, detyrë e Gjykatës është të shqyrtojë nëse përmbajtja e vendimit të kontestuar dhe procedura e ndjekur për miratimin e tij janë në kundërshtim me Kushtetutën, siç pretendohet nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se vendimi i kontestuar, për nga përmbajtja, shkel nenet 1, 3, 22, 24, 35, 45, 102, 103, 104, 114, 132, 134 dhe 135 të Kushtetutës, përderisa procedura e ndjekur me rastin e miratimit të Vendimit nr. 05-V-139 ishte në kundërshtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës.
57. Në mënyrë që të gjykojë lidhur me kërkesën e parashtruesve, është e nevojshme që Gjykata të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë dhe siç janë specifikuar më tej me Ligj. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar.
58. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës që përcakton:
- “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
59. Sa i përket këtyre kërkesave, Gjykata rikujton se parashtruesit e kanë ngritur kërkesën në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës që përcakton:
- “Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.*
60. Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga 24 deputetë të Kuvendit, brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të Vendimit nr. 05-V-139. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të ngritur në Gjykatë kërkesën që konteston këtë vendim.
61. Sidoqoftë, Gjykata më tej do të shqyrtojë kriteret e tjera të pranueshmërisë që janë të aplikueshme në rastin e tanishëm.

### ***Sa i përket vendimit të kontestuar***

62. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139 e Kuvendit, të 3 gushtit 2015. Në këtë vendim theksohet:

*“Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të neneve 65 (2) dhe 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.2 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 3 gusht 2015, pasi shqyrtoi Propozim-amendamentin nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mori këtë:*

#### **VENDIM**

- 1. Miratohet Amendamenti nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.*
- 2. Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës”.*

### ***Sa i përket aspektit përmbajtjesor të kërkesës***

63. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës] që përcakton:

*“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*

- a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;*
- b) kërkesa është anonime;*
- c) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i të drejtës për peticion;*
- d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;*
- e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*
- f) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën; ose*
- g) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.*

64. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se argumentet e parashtruesve të kërkesës kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Amendamentit XXIV, megjithëse ata pretendojnë se kontestojnë Vendimin nr. 05-V-139.

65. Kjo është gjithashtu e qartë nga pjesa përmbyllëse e aspektit përmbajtjesor të pretendimeve ku parashtruesit kërkojnë nga Gjykata *“... vlerësimin e kushtetutshmërisë së Amendamentit kushtetues nr. XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderojnë se dispozitat e këtij amendamenti në aspektin përmbajtjesor janë në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës”.*

66. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se neni 113.9 i Kushtetutës thotë:

*“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”.*

67. Gjykata po ashtu i referohet nenit 144.3 të Kushtetutës, që përcakton:

*“Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”.*

68. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Kushtetuta nuk i jep Gjykatës asnjë kompetencë për vlerësimin e një amendamenti kushtetues lidhur me përmbajtjen e tij, pas miratimit të të njëjtit. Kompetenca e Gjykatës, përkitazi me substancën e një amendamenti kushtetues, është që të vlerësojë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës, para se amendamenti të vihet për aprovim në Kuvend.

69. Gjithashtu, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi nr. AGJ469/13, i 9 shtatorit 2013, në rastin KO95/13, në paragrafin 97 e tutje). Ngjashëm me atë rast, Gjykata konsideron se Amendamenti XXIV i Kushtetutës dhe Vendimi nr. 05-V-139 i Kuvendit janë dy akte të ndara juridike. Secili prej këtyre akteve ndjek procedurë të ndryshme juridike, për vlerësim të kushtetutshmërisë së projektamendamentit, respektivisht për Vendimin që miraton amendamentin.

70. Gjykata rikujton se për miratimin e një amendamenti të Kushtetutës kërkohet një shumicë e veçantë votash në Kuvend, siç parashikohet në nenin 144.2. Në këtë dispozitë theksohet: *“Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”.*

71. Sa i përket miratimit të amendamentit XXIV, Gjykata vëren se Vendimi për miratim është marrë nga shumica e kërkuar, prej dy të tretave të Kuvendit, siç specifikohet me Kushtetutë. Kësisoj, Gjykata konsideron se Vendimi i Kuvendit për miratimin e Amendamentit XXIV ishte në pajtim me dispozitat procedurale të Kushtetutës.

72. Vendimi për miratimin e çdo amendamenti kushtetues, në këtë rast Amendamentit XXIV, është në substancën e tij shpallje se një amendament është miratuar me shumicën e kërkuar. Amendamenti, si i tillë, nuk mund të ndryshohet në kohën ndërmjet vlerësimit nga Gjykata dhe miratimit të tij nga Kuvendi, sepse çdo ndryshim në një dispozitë kushtetuese kërkon miratimin paraprak të Gjykatës sa i përket pajtueshmërisë së tij me dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës.

73. Prandaj, argumentet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me përmbajtjen e Amendamentit XXIV nuk mund të merren parasysh në këtë fazë. Argumente të asaj natyre u adresuan në mënyrën të duhur në Gjykatë në kohën kur vlerësimi i pajtueshmërisë së amendamentit me Kapitullin II ishte duke u shqyrtuar nga Gjykata. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se ua kishte shpërndarë kërkesën KO26/15 të gjithë deputetëve të Kuvendit, të cilëve u ishte dhënë mundësia të paraqitnin komentet e tyre për kushtetutshmërinë e Amendamentit XXIV në atë kohë (Shih Aktgjykimin AGJ 788/15, në Rastin KO26/15, të 15 prillit 2015, paragrafi 7).
74. Për më tepër, neni 144.4 i Kushtetutës thotë:
- “Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës”.*
75. Gjykata vëren se, me nenet 113.9 dhe 144.3, Kushtetuta vendos të gjitha konsideratat lidhur me vlerësimin dhe me konfirmimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese në periudhën kohore para miratimit të një amendamenti. Për këtë arsye, në nenin 144.4, Kushtetuta autorizon hyrjen e menjëhershme në fuqi të amendamenteve kushtetuese pas miratimit të tyre. Pajtueshmëria e amendamentit, si i tillë, me Kushtetutën nuk mund të jetë më objekt i kontestimit pasi që kjo është vlerësuar dhe është miratuar para vendimit për miratim të tij.
76. Në veçanti, Gjykata vëren se kjo procedurë dallon nga ajo që aplikohet te miratimi i ligjeve nga Kuvendi. Pas miratimit të një ligji, neni 113.5 i Kushtetutës lejon një periudhë prej 8 (tetë) ditësh pas miratimit të tij, gjatë së cilës së paku 10 (dhjetë) deputetë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e atij ligji.
77. Në pajtim me këtë dispozitë, neni 43.1 i Ligjit parashikon: *“Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës”.*
78. Në raste të tilla, kushtetutshmëria vlerësohet nga Gjykata pas miratimit të ligjit ose të vendimit, e jo para miratimit, dhe shpallja nga Presidenti i Republikës është e lidhur me referimin e ligjit ose të vendimit në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë.
79. Përveç kësaj, në raste të tilla, Kushtetuta parashikon në nenin 116.2: *“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme”.*
80. Kur bëhet fjalë për miratimin e një amendamenti të Kushtetutës, Gjykata gjen se hyrja në fuqi e amendamentit nuk varet nga shpallja që bën Presidenti i Republikës, por ai hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi, siç përcaktohet në nenin 144.4.

81. Kjo gjithashtu dëshmohej nga Vendimi nr. 05-V-139 i Kuvendit, në pikën 2, ku thuhet: *“Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës”*.
82. Edhe pse nuk është ngritur çështja nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata konsideron se, në këto rrethana, parashtrimi i një kërkesë sipas nenit 113.5 të Kushtetutës kundër Vendimit për miratimin e amendamentit nuk mund të pezullojë hyrjen në fuqi të vetë amendamentit, sepse hyrja e tij e menjëhershme në fuqi është drejtpërdrejt e rregulluar me dispozitë kushtetuese.
83. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] që përcakton:
- “1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”*.
84. Në rastin e tanishëm, Gjykata po ashtu vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë parashtruar ndonjë kërkesë në Gjykatë për pezullimin e Vendimit të kontestuar nr. 05-V-139. Rrjedhimisht, në këtë kërkesë, çështja e pezullimit të ndonjë veprimi ose e ndonjë ligji të kontestuar nuk paraqitet.
85. Gjykata rikujton se Amendamenti XXIV ka qenë objekt i vlerësimit paraprak nga Gjykata dhe ishte konfirmuar që ky amendament nuk zvogëlon të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe, me shkronjën dhe frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 15 prillit 2015, në Rastin KO26/15 *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 9 mars 2015, me Shkresën Nr. 05-433/DO-318*).
86. Më 3 gusht 2015, ky amendament i njëjtë u miratua nga Kuvendi me 82 vota për, me 5 vota kundër dhe me 1 abstenim.
87. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Amendamenti XXIV i Kushtetutës ka hyrë në fuqi në bazë të nenit 144.4 të Kushtetutës.
88. Rrjedhimisht, në kontekst të kësaj kërkesë, Gjykata konkludon se nuk ka juridiksion për të vlerësuar një amendament kushtetues sapo të jetë miratuar ai.
89. Gjykata vëren se, në parashtruesit e tyre, parashtruesit e kërkesës nuk kanë adresuar asnjë argument për përmbajtjen e Vendimit të kontestuar nr. 05-V-139 për miratimin e Amendamentit XXIV. Kësisoj, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur ankesat e tyre në lidhje me këtë vendim.
90. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullat 36 (3) (a) dhe 36 (3) (e), Gjykata i gjen të papranueshme pretendimet përkitazi me përmbajtjen e vendimit të kontestuar.

### ***Sa i përket aspektit procedural të kërkesës***

91. Gjykata vëren se, përkitazi me aspektin procedural të kërkesës, argumenti kryesor i parashtruesve të kërkesës në mbështetje të pretendimit të tyre për shkelje procedurale ndërtohet rreth faktit se Kryetari i Kuvendit e riprocedoi amendamentin e propozuar pa e referuar Amendamentin e propozuar XXIV për vlerësim në Gjykatë, sipas nenit 144.3 të Kushtetutës, para votimit për amendamentin e riproceduar.
92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, që parashikon:
- “1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.*
93. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton se, para se t'i hynte vlerësimin të kësaj kërkesë, ka kërkuar informacione nga të gjitha palët e përfshira: nga Qeveria, si sponsorizuese e Amendamentit XXIV, nga Kryetari i Kuvendit, i cili ua ka dërguar amendamentin e propozuar deputetëve, si dhe nga parashtruesit e kërkesës, që të dorëzonin në Gjykatë, *inter alia*, tekstin e amendamentit të propozuar dhe tekstin e amendamentit të miratuar.
94. Në kohën e duhur, Gjykata pranoi nga Qeveria: Amendamentin e propozuar XXIV, të riproceduar; nga Kryetari i Kuvendit: tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV, të riproceduar dhe të votuar; si dhe nga parashtruesit e kërkesës: tekstin e Amendamentit të miratuar XXIV.
95. Me qëllim të kontrollimit të përmbajtjes së këtij amendamenti, Gjykata krahasoi këto tekste me përmbajtjen e amendamentit të propozuar, të cilin e kishte vlerësuar më herët në Rastin KO26/15.
96. Gjykata vëren se parashtruesit gjithashtu theksojnë në kërkesën e tyre që projektamendamenti i riproceduar kishte të njëjtën përmbajtje sikurse projektamendamenti i votuar dhe i refuzuar nga Kuvendi më 26 qershor 2015, që ishte dorëzuar në Gjykatë dhe që ishte vlerësuar në aktgjykimin e saj të 14 prillit 2015.
97. Qeveria po ashtu konfirmoi, në letrat e saj të 18 dhe 28 gushtit 2015, si përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informacione, se projektamendamenti i riproceduar në Kuvend më 31 korrik 2015 ishte identik me projektamendamentin që ishte dorëzuar më herët në Gjykatë për vlerësim nga ana e saj në Rastin KO26/15.

98. Për më tepër, Kryetari i Kuvendit, në letrën e tij të 17 gushtit 2015, si përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informacione, theksoi:

*“Qeveria e Republikës së Kosovës, më 31 korrik 2015, e ka ri-proceduar në Kuvend Amendamentin nr. 24, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të vlerësuar me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për Rastin KO26/15, Nr. ref.: AGJ 788115, datë 15 prill 2015”.*

99. Në këtë kontekst, Gjykata konkludoi se përmbajtja e Amendamentit të propozuar XXIV, siç ishte dorëzuar në Gjykatë për vlerësim paraprak më 9 mars 2015, është identike me tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV, që ishte riproceduar nga Qeveria dhe që ishte përcjellë nga Kryetari i Kuvendit të gjithë deputetët më 31 korrik 2015. Për më tepër, teksti i amendamentit, që u miratua më 3 gusht 2015 dhe që më pastaj u publikua në Gazetën Zyrtare pas dy ditësh, mbetet identik me tekstin fillestar që është vlerësuar më herët nga Gjykata.
100. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se nuk ka pasur nevojë që amendamenti i propozuar të referohet për herë të dytë, pasi që i njëjti tashmë ishte vlerësuar një herë dhe përmbajtja e tij nuk ka pësuar ndonjë ndryshim apo modifikim.
101. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se janë shkelur procedurat kushtetuese pasi që, pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Kryesisë së Kuvendit, të 31 korrikut 2015, materialet e ndërlidhura me projektamendamentin nuk iu dorëzuan deputetëve.
102. Mirëpo, Gjykata vëren se, së bashku me shkresën e saj të 17 gushtit 2015, Kryesia e Kuvendit ofroi kopjen e dosjes së plotë, ashtu siç u ishte dorëzuar më 31 korrik 2015 të gjithë deputetëve para votimit të 3 gushtit 2015. Si e tillë, kjo dosje përmbante Vendimin 01/41 e Qeverisë për riprocedimin e Amendamentit XXIV në Kuvend, tekstin e Amendamentit të propozuar XXIV dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese AGJ788/15, të 14 prillit 2015, në Rastin KO26/15.
103. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të ofrojnë prova në mbështetje të kësaj ankese.
104. Gjykata rikujton se në bazë të nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit, në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, *“ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme: [...] 1.3 paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”*.
105. Gjithashtu, rregulli 36 (2) (d) i Rregullores së punës parashikon: *“Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
106. Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës dështuan të paraqesin prova për të dëshmuar pretendimet e tyre në mbështetje të kontestit të tyre për shkelje të Kushtetutës.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 42, paragrafi 1.3, të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 36 (2) (d), 36 (3) (a) dhe 36 (3) (e) të Rregullores së punës, më 21 shtator 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi